



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Prania / Dorezuar Punjenos/Prodato Received/Debitory	01.07.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Orgn /Jednitca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	3877/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A Nr.440/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga Malsore Gashi – Bajraktari -kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 440/2022 të datës 06.05.2022 të parashtruar nga ankuesi me adrese kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridik “ kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.07.2022, mori këtë

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A. Nr. 440/2022, e datës 06.05.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit me Nr. Prot:02/840/09 të datës 24.10.2019 në pozitën “Zyrtar i Lartë i Kualitetit të MD” në Administratën Tatimore të Kosovës, më datë 22.03.2022 ka parashtruar kërkesë për pagesë të shpenzimeve për ushqim tek Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore, ndërsa më datë 07.04.2022 Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore i kthen përgjigje në kërkesën e datës 22.03.2022 të parashtruar nga ankuesi.

Ankuesi pakënaqur me përgjigjeje e datës 07.04.2022 nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore, me datë 06.05.2022, parashtron ankesë me numër protokolli 2636/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me kompensimin e shpenzimeve të ushqimit sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2008, për pagese të shpenzimeve për të punësuarit në Administratën Tatimore të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 18.05.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigjen në ankesë tek Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa më datë 26.05.2022, Administrata Tatimore e Kosovës, ka dërguar përgjigje në ankesë tek Këshillit.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike ,për marrjen e vendimit meritot ka administruar këto prova: Ankesën e datës 06.05.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokollit 2636/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 22.03.2022 drejtuar Menaxheres se Personelit ne ATK; Përgjigje në kërkesë e datës 07.04.2022 nga Menaxherja e Personelit e ATK-së; Akt Emërimi i datës 20.11.2019; Përgjigje në ankesë e datës 26.05.2022, me numër protokollit 3051/2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se organi i punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, është e obliguar që ti bëjë kompensimin e ushqimit sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2008, për Kompensimin e Pagesës së Shpenzimeve për Ushqim për Nëpunësit e Administratës Tatimore të Kosovës, me shumen prej tri (3) €, për çdo dite të pranisë në punë nga data 04.05.2011 deri me datën 22.12.2021 sepse ky udhëzim administrativ është shfuqizuar vetëm ne vitin 2021 konkretisht me Vendimin numër 01/50 te datës 23.12.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi që i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe i ka shqyrtuar të gjitha faktet relevante lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me kompensimin e shpenzimeve lidhur me shujtën ditore me shumen prej tri (3) €, nuk janë të bazuara sepse Kuvendi i Republikës se Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: **1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut.** Përkitazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës se Kosovës, me datë 24.12.2012 ka aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht edhe Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2008, për Kompensimin e Pagesës së Shpenzimeve për Ushqim për Nëpunësit e Administratës Tatimore të Kosovës, kështu që duke u bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për realizimin e kompensimit për ushqim sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2008, për Kompensimin e Pagesës së Shpenzimeve për Ushqim për Nëpunësit e Administratës Tatimore të Kosovës, është i pa bazuar.

Po ashtu bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se Ministri i Ministrisë se Financave, me datë 08.04.2011 ka nënshkruar Udhëzimin Administrativ Nr.02/2011 për Vendosjen e Pagesave të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës, qëllimi i te cilit ka qenë ndërtimi i sistemit të pagesave për personelin e Administratës Tatimore të Kosovës, në

funkcion të rritjes së efikasitetit dhe përgjegjësi konform zbatimit të dispozitave të nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, dhe mbi bazën e kësaj të gjitha kompensimet për të punësuarit në Administratën Tatimore të Kosovës, që nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi respektivisht nga data e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë se Financave janë të rregulluara sipas këtij udhëzimi. Kolegji po ashtu ka analizuar Udhëzimin Administrativ Nr.02/2011 për Vendosjen e Pagesave të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës, dhe ka konstatuar se me këtë udhëzim nuk është parapa kompensimi i ushqimit në lartësi të shumes prej tri (3) €, ashtu siç ka pretenduar ankuesi në ankesën

e parashtruar në Këshill, por që me këtë udhëzim është rregulluar shtesa mbi pagën bazë dhe personeli i ATK-së nga muaji prill i vitit 2011 ka përfituar gjegjësisht ka realizuar pagesën e pagës bazë dhe shtesat mbi pagën bazë të përcaktuar sipas skemës së bashkangjitur në Udhëzimin Administrativ Nr.02/2011 për Vendosjen e Pagesave të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës konkretisht „Aneksit A”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit cili pretendon se Udhëzimi Administrativ Nr.04/2008, ka qenë në fuqi edhe pas datës 08.04.2011 sepse sipas tij ky udhëzim është shfuqizuar vetëm në vitin 2021, konkretisht me Vendimin numër 01/50 të datës 23.12.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nuk janë të bazuara sepse në baze të analizimit të dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2011 për Vendosjen e Pagesave të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës, përkatësisht nenit 4 ku përcaktohet se „Ky udhëzim hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Financave” Kolegji konstaton se ky udhëzim është nënshkruar nga Ministri i Ministrisë së Financave me datë 08.04.2011, andaj Kolegji konstaton se nga data e nënshkrimit konkretisht nga data 08.04.2011 lidhur me kompensimin e shtesave në page vlejné dispozitat e Udhëzimit Administrativ 02/2011, për Vendosjen e Sistemit të Pagesave për Personelin në Administratën Tatimore të Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda Nr. A. Nr. 440/2022

Rushit KAJTAZI

Proçesmbajtës

Malsore GASHI - BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit*
- *Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*